

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. G. nga fsh. ... KK Prizren, për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 186 par.1 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.2435/2013 të datës 19.03.2015, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, në prezencën e Prokurorit Themelore në Prizren Merheme Hoxha, të akuzuarit, me datë **08.01.2016**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari F. G., nga i ati M., e ëma H., e vajzërisë B., i lindur më datë ... në fsh. ... KK Prizren, ku edhe tani jeton, i martuar baba i 4 femijeve, ka të kryer shkollën fillore, drejtor i kompanis private, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Se prej kohes se pavartetuar e gjer me dt.18.01.2013 me sjellje apo komunikimin e tij te vazhdueshem me qellim te ngacmimit, frikesimit dhe me keto veprime e ve personin nen frike te arsyeshme, ne ate menyre qe i pandehuri vazhdimisht e shqeteson te demtuaren J. Q., per shkak se i kishin prishur raportet ne mes vete, duke thirrur ne telefon si dhe duke postuar ne rrjetin social "Face-book" nje fotografi ne te cilin kishin dalur se bashku para shume kohesh,

-kësodore kryen veprën penale ngacmimi nga neni 186 par.1 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 7, 43, par.1 pika 1.3, 46, 73 te KP-se , si dhe nenit 365 te KP-se, te akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBE

Ne lartesi prej **200 /dyqinde/ Euro** te cilen shume te denimit i akuzuari eshte i obliguar te paguaj ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njejt do te zevendesohet me denim burgu duke llogaritur per çdo 20 Euro nje dite burg, rrespektivisht 10 dite burgim.

I akuzuari obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise se gjykates, ndersa në emër të paushallit gjygjësor shumën prej **50 Euro**, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E demtuara J. ... A ... Q ... nga Prizreni ... per realizimin e kerkeses pasuroro juridike, udhezohet ne kontest te rregullt civilo juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP. nr. 2435/2013 te dt.19.03.2015, kunder te akuzuarit F ... G ... nga fsh. ... KK Prizren, per shkak te vepres penale ngacmimi nga neni 186 par.1 te KP-es.

Prokurori Themelore ne Prizren Mehreme Hoxha, ne fjalen e saje perfundimtare ka deklaruar se qendron ne teresi prane aktakuzes, me arsyetim se nga deklarata e te akuzuarit se i njeiti e pranon fajesine ne menyre vullnetare, poashtu edhe sipas provave te cilat iu jane bashkangjitur kesaj aktakuze eshte vertetuar ne teresi gjendja faktike e pershkruar si ne dispozitiv te aktakuzes, prandaj propozon gjykates qe i akuzuari te shpallet fajtor dhe te denohet sipas ligjit.

I akuzuari ne fjalen e tije perfundimtare deklaroi se e ndien vehten fajtor per vepren penale e cila i vihet ne barre nga ana e PTH-es ne Prizren, dhe i propozon gjykates qe te kete parasysh faktin se i njeiti duke e pranuar fajesine ne menyre vullnetare, me sinqeritetin dhe karakterin me te larte njerezor, sa i perket vepres penale te ngacmimit, eshte i penduar thellesisht per kete veper penale, me te demtuaren e ka gjetur gjuhen e pajtimit dhe te mirekuptimit, me pare i pagjykuar, mbajtes i familjes 31 anetareshe.

Gjykata ne shqyrtim kryesor ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesis nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajesis per vepren penale e cila i vihet ne bare, e qe pranimi i fajesis eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykat ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesis nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale ngacmimi nga neni 186 par.1 te KP-se, dhe per kete gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesis nga ana e te akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, me pare i pagjykuar, cka nenkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive ne kuptim te dispozitave te nenit 74, 75, e 76 gjykata morri per baze edhe faktin qe i akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tije ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, ka pranuar fajesin dhe ka shprehur keqardhje per vepren e kryer penale dhe poashtu edhe ka pasur sjellje korrekte para gjykates, me te demtuaren e ka gjetur gjuhen e pajtimit dhe te mirekuptimit, eshte mbajtes i familjes 31 anetareshe, andaj gjykata i shqiptoi denimin me gjobe sepse konsideron se me me kete mase sanksionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete i kujdesshem dhe do te permbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 450, e 451 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr. 542/2015 të datës 08.01.2016

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari



UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgjykimi pala e pakenaqur ka te drejte ankese në afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtes, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.